

PROCESVERBAL
nga seanca Konstitutive e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 03.07.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Sasho Stefanovski, Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Viktor Pavlovski.

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drajtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Emilija Janevska, Magdalena Dovleva Davidovska, Goran Radunović, Argjend Xhelili, Maja Damevska, Jeton Ismaili.

Të pranishmit e tjerë: Lazo Petrushevski.

Kryetari i Këshillit nga përbërja e mëparshme, Lazo Petrushevski, e hapi seancën konstitutive të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski shpjegoi se anëtarët e rinj të Këshillit të ASHMA-së u zgjodhën në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 24 qershor 2025. Në këtë drejtim, ai i uroi për zgjedhjen e tyre, ju dëshiroi suksese në punë dhe shëndet në jetë.

Këshilli i Agjencisë, njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
2. Zgjedhja e Zëvendëse Kryetares së Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të mallrave, me vlerë të përcaktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik.

Pika 1

Z.Petrushevski dha shpjegim për procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ai informoi se, në përputhje me Rregulloren e Punës së Agjencisë, Këshilli nga anëtarët e tij zgjedh kryetar dhe zëvendës kryetar. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të propozojë një kandidat për kryetar, propozim i cili mund të jipet gojarisht ose me shkrim në vetë seancën. Nëse propozohen disa kandidatë, votimi do të realizohet me rend alfabetik, sipas mbiemrave të kandidatëve. Për më tepër, z.Petrushevski theksoi që Këshilli të mundë të punojë, është e nevojshme prania e së paku pesë anëtarëve nga gjithësej shtatë. Për të marrë vendime të vlefshme, nevojitet së paku katër vota „pro“, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm. Pas këtij shpjegimi, z.Petrushevski u bëri thirrje anëtarëve të pranishëm të propozojnë kandidatë për funksionin e Kryetarit të Këshillit.

Anëtari i Këshillit, z. Petar Xhunovski, ka propozuar z. Sasho Stefanovski për Kryetar të Këshillit. Në shpjegimin e tij, ai theksoi përvojën e tij shumëvjeçare në punë, duke vlerësuar se është më kompetent për funksionin.

Anëtarja e Këshillit, znj. Afrona Vrzivolli, gjithashtu e mbështeti propozimin dhe e propozoi z. Stefanovski për Kryetar.

Anëtarja e Këshillit, znj. Zirjeta Jajaga, iu bashkua propozimit, duke theksuar se z.Sasho Stefanovski ka përvojë të pasur dhe të dëshmuar profesionale që daton që nga viti 1987. Ajo në veçanti theksoi profesionalizmin, përkushtimin dhe integritetin e tij, si cilësi kyçe për funksionimin e mëtejshëm me sukses të Këshillit të Agjencisë në tërësi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri për Kryetar të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka zgjedhur z. Sasho Stefanovski.

Pas zgjedhjes, z. Sasho Stefanovski falënderoi anëtarët e pranishëm të Këshillit për besimin e treguar dhe për urimet e dërguara me rastin e zgjedhjes së tij për Kryetar të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pika 2

Kryetari i Këshillit, z. Sasho Stefanovski, e hapi pikën e dytë të rendit të ditës – zgjedhjen e Zëvendës Kryetarit të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe iu drejtua anëtarëve të Këshillit të propozojnë kandidatë.

Anëtarja e Këshillit, z. Cvetanka Minovska, për Zëvendës Kryetare e propozoi znj.Zirjeta Hajro Jajaga. Në shpjegimin e saj, ajo deklaroi se profesionalisht e njehej kandidaten dhe e konsideron si person që mund me përgjegjësi dhe efikasitet të kryejë detyrat që rrjedhin nga funksioni. Ajo theksoi përvojën e saj shumëvjeçare në gazetari, integritetin profesional, njohuritë e saj për punën e Agjencisë, si dhe potencialin e saj për të kontribuar në përparimin e mëtejshëm të Këshillit dhe për të qenë një mbështetje e rëndësishme për Kryetarin.

Kryetari i Këshillit, z. Sasho Stefanovski, shprehu mbështetje për kandidaturën e propozuar dhe theksoi se znj. Zirjeta Harjo Jajaga e njehej prej kohësh. Ai shtoi se me kënaqësi e pranon mundësinë për bashkëpunim të përbashkët në mandatin e ardhshëm, duke vlerësuar se përvoja e saj dhe qasja profesionale do të kontribuojnë në punën efikase dhe konstruktive të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota „pro“ dhe një abstenim nga Afrona Vërzivolli, për Zëvendëse Kryetare të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele zgjodhën Zirjeta Hajro Jajaga.

Pika 3

Z. Trajçevski dha shpjegim për Propozimin i cili i referohet furnizimit të mallrave me vlerë të përcaktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Ai theksoi se bëhet fjalë për pajisje shtesë për zyrat e anëtarëve të Këshillit, të cilat tashmë janë rinovuar, por ende nuk janë siguruar dyer të reja. Ai theksoi se janë kërkuar oferta nga operatorë ekonomikë, duke iu bashkëngjitur materialeve të paraqitura anëtarëve të Këshillit sipas kësaj pike të rendit të ditës. Plotësuese, ai shpjegoi se Këshilli nuk voton për ofertë konkrete, por pranon procentin e shumës së parashikuar për furnizim dhe bazuar në këtë, i jep miratim drejtorit për të marrë vendim për përzgjedhjen e ofertuesit, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligj.

Anëtarja e Këshillit znj. Majnova, shtroj një pyetje në lidhje me Planin Vjetor për Furnizim Publik të Agjencisë për vitin 2025, përkatësisht nëse ai është miratuar dhe nëse është publikuar në ueb faqen e Agjencisë.

Në përgjigje, z. Trajçevski informoi se Plani Vjetor për Furnizim Publik për vitin 2025 u miratua në fund të vitit 2024, pas së cilës u publikua në ueb faqen zyrtare të Agjencisë, në përputhje me detyrimet ligjore për transparencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratimin drejtorit të Agjencisë, të miratojë Vendim me të cilin miratohen mjetet financiare për furnizim të mallrave: dyer të brendshme në ndërtesë, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës sipas Ligjit për Furnizim Publik, në shumë prej 29.400,00 denarë pa TVSH, përkatësisht një shumë totale prej 34.629,00 denarë me TVSH.

Për realizimin e furnizimit të lartpërmendur mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Агенција за аудио и аудиовизуелни
медиумски услуги
Претседател на Советот**

м-р Сашо СТЕФАНОВСКИ